

KODI ETIK I AVOKATIT

HYRJE

Të ndërgjegjshëm për rolin dhe detyrën e avokatit në një shoqëri demokratike, të bazuar në parimet e shtetit ligjor, të humanizmit dhe dinjitetit njerëzor, me respekt ndaj të vërtetës dhe drejtësisë, hartohet Kodi Etik i Avokatit.

NATYRA E RREGULLAVE DHE SJELLJES PROFESIONALE

Normat e Kodit Etik bazohen në:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
2. Marrëveshjet Ndërkombëtare të Ratifikuara
3. Legjislacionin në fuqi dhe veçanërisht Ligji nr.9109 datë 17.7.2003 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”
4. Statuti i Dhomes Kombetare te Avokateve te Shqiperise
5. Zakonet dhe Traditën e profesionit të avokatit në Shqipëri.

Funksioni i Avokatit mbështetet mbi një shumëllojshmëri detyrimesh ligjore dhe morale kundrejt

- 1) Klientit
- 2) Gjykatës dhe autoriteteve të tjera përpara të cilave avokati mbron çështjet e klientit ose vepron për llogari të tij.
- 3) Dhomës së Avokatisë në përgjithësi dhe çdo anëtar të saj në mënyrë të veçantë
- 4) Publikut, për të cilin ekzistenca e nje profesioni të lirë, të pavarur dhe vetë organizuar është një mjet themelor për ruajtjen e të drejtave të njeriut përballë fuqisë së shtetit dhe interesave të tjera në shoqëri.

QËLLIMI I KODIT ETIK

Kodi synon të trajtojë vendosjen, respektimin dhe zbatimin e rregullave të sjelljes, të etikës profesionale të avokatit në shërbim të mbrojtjes të të drejtave dhe interesave legjitime të klientit dhe në shërbim të interesave të drejtësisë.

KAPITULLI I PARIMET E PËRGJITHSHME

PAVARËSIA E AVOKATIT

Neni 1

Avokati është i pavarur në ushtrimin e profesionit të tij.

Për të siguruar pavarësinë avokati duhet të jetë i lirë nga çdo ndikim që mund të lindë nga interesat e tij personale ose nga presioni i jashtëm.

Neni 2

Avokati në ushtrimin e profesionit vepron në përputhje me ligjin, Statutin, Kodin e Etikës dhe interesat e ligjshme të klientit duke i ofruar atij shërbimet profesionale të mbështetura në gjykimin e tij më të mirë.

Neni 3

Pavarësia e avokatit është aq e nevojshme për të besuar në procesin e drejtësisë sa edhe paanshmëria e gjyqtarit.

Avokati duhet të shmangë çdo cënim të pavarësisë së tij dhe të mos kompromentojë standartet profesionale për të kënaqur klientin, gjykatën apo të tretët.

DINJITETI I PROFESIONIT

Neni 4

Avokati gjithnjë duhet të ruajë dinjitetin e profesionit.

Avokati detyrimisht mban të ekspozuara në zyrën e tij.

- Çertifikaten e titullit “Avokat”
- Flamurin shqiptar dhe atë të Dhomës Kombëtare të Avokatëve në tavolinën e punës
- Tarifen minimum të shpërblimit të punës së avokatit.

Avokati nuk duhet të bëjë deklarata fyese ose përbuzëse për aktivitetin apo vendimet e gjykatave apo autoriteteve të tjera.

Avokati duhet të nxisë edhe klientin që të sillet me respekt ndaj gjykates apo autoriteteve të tjera.

Për të ruajtur reputacionin e mirë të vetes dhe Dhomës së Avokatëve, avokati nuk duhet të tolerojë sjellje jo korrekte dhe me mungesë respekti nga ana e gjykates dhe kujt do tjetër kundrejt vetë avokatit, asistentit, nxënësit apo klientit.

Kultura e përgjithshme dhe ajo juridike e avokatit duhet të manifestohet në çdo moment gjatë ushtrimit të profesionit, në paraqitjen e tij, në fjalët që mban dhe në mardhëniet që krijon me këdo.

Avokati paraqitet në procesin e gjykimit me kartën e identitetit për çdo vit dhe uniformën e avokatit.

Avokati nuk mund të përfshihet në veprime që kanë të bëjnë me pandershmëri apo keq përfaqësimin.

Avokati, në praktikë dhe në jetën e tij private, duhet të qëndrojë larg çdo sjelljeje, e cila mund të zhvlerësojë emrin e mirë të profesionit.

PËRKUSHTIMI DHE AFTËSITË

Neni 5

Avokati në çdo kohë duhet të veprojë me përkushtim dhe gatishmëri kur përfaqëson një klient.

Neni 6

Avokati ka për detyrë t'u shërbejë interesave të klientit në mënyrën më efikase të mundur.

Neni 7

Avokati duhet të ofrojë përfaqësim cilësor të klientit. Aftësia përfshin njohuritë ligjore dhe aftësitë profesionale të cilat janë të nevojshme në çdo rast konkret.

Neni 8

Avokati nuk duhet të trajtojë një çështje për të cilën ai nuk ka aftësitë e nevojshme përveç se kur bashkëpunon me një avokat i cili është kompetent për ta trajtuar atë.

Neni 9

Avokati ka për detyrë të zhvillojë aftësitë e tij nëpërmjet përgatitjes së vazhduar profesionale.

VEPRIMTARI DHE PUNËSIME TË PAPAJTUESHME

Neni 10

Me qëllim kryerjen e funksioneve të tij me pavarësinë e duhur dhe në një mënyrë të pajtueshme me detyrën e tij për të marrë pjesë në administrimin e drejtësisë, avokati duhet të përjashtohet nga disa veprimtari. Llojet dhe numri i këtyre veprimtarive përcaktohen në Ligjin Nr. 9109 date 17.7.2003 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Një avokat që punon më vete ose në partneritet nuk duhet të përfshihet në asnjë veprimtari tjetër nëse, duke vepruar kështu mund të cënohet pavarësia.

Neni 11

Avokatit i ndalohet të formojë ortakëri me një person që nuk është avokat në rast se veprimtaria e ortakërisë përbëhet nga ushtrimi i avokatisë.

Neni 12

Avokati nuk duhet të ndihmojë një jo avokat për të ushtruar një profesion jo të autorizuar.

Neni 13

Avokati ose zyra e avokatisë nuk ndan tarifa ligjore me një person që nuk është jurist.

Avokati nuk mund t'i kërkojë, pranojë apo paguajë një avokati tjetër, ose një personi tjetër tarifë apo çdo lloj tjetër shpërblimi për dergimin apo rekomandimin e një klienti.

KONFIDENCIALITETI

Neni 14

Konfidencialiteti që buron nga ligji dhe normat e etikës profesionale është e drejtë, detyrim dhe garanci për avokatin. Avokatit për shkak të informacionit të veçante që merr nga klienti në kushtet e mirëbesimit nuk i lejohet të shkelë kërkesat e Nenit 9 të Ligjit “Për Ushtrimin e Profesionit të Avokatit në Republikën e Shqipërisë”

Avokati duhet të ruaje konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë nga klienti i tij ose të marrë prej tij, rreth këtij klienti ose të tjerëve, gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk është i kufizuar në kohë.

Avokati duhet t'iu kërkojë ortakëve dhe stafit të tij dhe gjithkujt tjetër të angazhuar prej tij gjatë ofrimit të shërbimeve profesionale të ruajnë konfidencialitetin.

Detyrimi i konfidencialitetit nuk shkelet kur:

- a) Avokati informon një person të cilit ai është duke i deleguar detyrat individuale për shërbime ligjore mbi ecurinë e çështjes në fjalë, me kusht që edhe një person i tillë t'i nënshtrohet detyrimit të konfidencialitetit.
- b) Tregon konfidenca ose sekrete me pëlqimin e klientit ose të klientëve në fjalë, por vetëm pasi t'ua tregojë plotësisht atyre këtë gjë.
- d) Tregon konfidenca ose sekrete të nevojshme për të caktuar ose marrë pagesën e avokatit ose për të mbrojtur avokatin ose nëpunësit e tij ose ortakët kundër një akuze për sjellje të gabuar.

KAPITULLI II

MARRËDHËNIET ME KLIENTËT

Neni 15

INTERESAT E KLIENTIT

Avokati duhet të veprojë gjithnjë për interesat më të larta të klientit të tij. Marrëdhënia e besimit me klientin është detyrim profesional. Besimi arrihet kur avokati karakterizohet nga ndeshmeria dhe integriteti.

Neni 16

DETYRA PËR TË INFORMUAR KLIENTIN

Avokati duhet t'i shjegojë klientit ligjin dhe linjën e veprimit që ai do të ndjekë duke evidentuar pasojat e mundshme ligjore në favor ose në disfavor të tij. Avokati duhet t'i pergjigjet kërkesave të arsyeshme të klientit për informacion.

Avokati duhet të informojë klientin e tij rreth çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me përfaqësimin në kohë me qëllim që klienti, në mënyrë të arsyeshme, të mbrojtë veten, ose të shfrytëzojë një mundësi të ofruar nga ligji, duke përfshirë edhe çdo zgjidhje të ofruar nga pala tjetër.

Neni 17

KTHIMI I DOKUMENTAVE

Me kërkesën e klientit të tij, avokati duhet t'i kthejë çdo dokument origjinal të marrë nga klienti për shkak të përfaqësimit të tij.

Neni 18

PASURITË DHE FONDET E KLIENTIT

Avokati, me miratimin e klientit mund të hyjë në administrim të pasurive të klientit dhe fondeve të tij që mund të jenë të depozituara në bankë.

Për këto fonde dhe pasuri të klientit, avokati mban dokumentacion të plotë për veprimet e kryera. Dokumentacioni ruhet për një periudhë kohe prej 7 vjetësh duke filluar nga perfundimi i përfaqësimit të çështjes. Për çështjet penale ky afat fillon nga momenti i perfundimit të vuajtjes së denimit.

Fondet mbahen në llogari të veçantë në vendin ku ndodhet zyra e avokatit ose në një vend tjetër ku për këtë ka miratim nga klienti.

Neni 19

Për marrjen e fondeve apo çdo pasurie tjetër në pronësi të klientit, avokati detyrohet të njoftojë klientin.

Avokati duhet të mbajë të ndara fondet e klientit nga fondet e tij.

Me kërkesën e klientit, avokati i kthen menjëherë atij të gjitha fondet ose pasuritë dhe me iniciativën e tij apo me kërkesë të klientit, bën kontabilizimin e plotë në lidhje me këtë pasuri.

Neni 20

KONFLIKTI I INTERESAVE

Avokati nuk mund të japë ndihmë juridike, të këshillojë, të përfaqësojë apo mbrojë në emër të dy ose më shumë klientëve në të njëjtën çështje, në rast se ka konflikt interesash të atyre klientëve midis tyre.

Neni 21

Avokati nuk përfaqëson dhe heq dorë nga perfaqesimi apo mbrojtja e dy ose më shumë personave, kur lind një konflikt interesash midis klientëve, kur avokati bindet se përfaqësimi do të çenojë marrëdhëniet me klientin tjetër.

Neni 22

Avokati që më parë ka përfaqësuar një klient në një çështje, nuk përfaqëson një klient tjetër në të njëjtën çështje, kur interesat e këtij personi u sjellin dëm interesave të klientit të mëparshëm.

Përfaqësimi lejohet përjashtimisht, vetëm në rast se klienti i mëparshëm jep pëlqimin e tij.

Neni 23

Avokati duhet gjithashtu të tërhiqet nga përfaqësimi ose mbrojtja në rast se ekziston rreziku i shkeljes të besimit të klientit të mëparshëm, ose në rast se njohja që zotëron avokati për çështjen e klientit të mëparshëm, do të përbënte epërsi të padrejtë për klientin e ri.

Rregulli i mësipërm është i barazvlershëm edhe për rastin kur profesioni i avokatit ushtrohet në ortakëri, apo nga e njëjta zyre.

Neni 24

Avokati nuk duhet të përfshihet në transaksione biznesi me një klient nëse ai dhe klienti kanë interesa të ndryshme si dhe kur klienti pret nga avokati që ai ta ushtrojë gjykimin profesional për mbrojtjen e klientit, përveçse kur:

- 1) transaksioni dhe kushtet në të cilat avokati ka fituar interesa janë të drejta, të arsyeshme për klientin dhe i janë deklaruar në mënyrë të plotë dhe transmetuar me shkrim në një mënyrë që të kuptohet si e arsyeshme nga ana e klientit;
- 2) Avokati këshillon klientin të kërkojë këshillat e një avokati të pavarur lidhur me transaksionin; dhe
- 3) Klienti jep miratimin e tij me shkrim, mbas deklarimit të plotë të kushteve të transaksionit dhe të konfliktit të qenësishëm të interesit në këtë transaksion.

Neni 25

Avokati duhet të mos punojë për një klient të ri nëse ka rrezik të shkelen konfidencat që i janë besuar avokatit nga një ish klient ose nëse njohuritë janë përfituar si rezultat i punësimit të mëparshëm si një punonjës shtetëror.

Neni 26

NDËRPRERJA E PËRFAQËSIMIT DHE E MBROJTJES

Avokati mund të ushtrojë të drejtën e tij për të hequr dorë nga përfaqësimi apo mbrojtja.

Avokati tërhiqet nga përfaqësimi apo mbrojtja kur klienti nuk arrin të përmbushë detyrimet juridike, morale dhe financiare ndaj avokatit në lidhje me shërbimet e tij dhe kur më parë është paralajmëruar nga avokati që do të tërhiqet në rast se detyrimet nuk përmbushen.

Neni 27

Me ndërprerjen e përfaqësimit apo të mbrojtjes, avokati në marrëveshje me klientin, merr masa që ai i vlerëson të arsyeshme për mbrojtjen e interesave të klientit duke e njoftuar atë në kohë të përshtatshme, por gjithnjë jo më pak se 15 ditë, për t'i dhënë atij mundësinë të gjetjes së një avokati tjetër.

Neni 28

TARIFAT

1) Avokati ka të drejtë të kete një tarifë për shërbimet e tij. Tarifa duhet të përcaktohet në një marrëveshje me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit të tij. Në mungesë të marrëveshjes me shkrim tarifa duhet të përcaktohet në përputhje me normat e tarifave të parashikuara nga "Tarifa e Shërbimeve Juridike të Avokateve", të miratuara nga Dhoma

Kombëtare të Avokatisë . Në te dy rastet, tarifa nuk duhet të jetë më e ulët se ajo minimale, e përcaktuar në normat e tarifave për këtë lloj shërbimi.

2) Tarifa e një avokati duhet të jetë e arsyeshme dhe e drejtë. Faktorët që duhet të konsiderohen për të përcaktuar se sa e arsyeshme është një tarifë përfshijnë:

- a) koha dhe puna e kërkuar, risia dhe vështirësia e çështjeve të përfshira dhe aftësite e kërkuara për të kryer shërbimet ligjore;
- b) kufizimet kohore të imponuara nga rrethanat;
- c) natyra dhe kohëzgjatja e marrëdhënieve profesionale me klientin;
- d) përvoja, reputacioni dhe aftësia e avokatit ose avokatëve, në kryerjen e shërbimeve;
- dh)si dhe faktore të tjera të cmuar nga ai:

3) Avokati nuk duhet të ketë të drejtë të bëjë një pactum de quota litis. Me “pactum de quota litis” kuptohet një marrëveshje e arritur përpara përfundimit të çështjes, e cila përcakton tarifat që duhet t’i paguhen avokatit vetëm për rezultatet e arritura dhe në të cilën klienti merr përsiper t’i paguaje avokatit një pjesë të rezultatit të arritur.

4) Avokati lejohet të përcaktojë “tarifat e rezultateve” me përjashtim të çështjeve të së drejtës familjare ose penale. Me “tarifa të rezultateve” kuptohen:

- a) Marrëveshjet me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit, sipas të cilit avokati merr përsipër të fillojë një çështje ose rast sipas tarifave minimale të përcaktuara dhe klienti bie dakort të paguajë një shumë të arsyeshme fikse në varësi të rezultateve pozitive të tij. Sasia mund të përkufizohet si shumë totale ose si një përqindje e parave të përcaktuara nga vendimi i gjyqit.
- b) Marrëveshja me shkrim ndërmjet avokatit dhe klientit sipas të cilës avokati merr përsipër të fillojë një çështje ose rast me tarifen minimale të përcaktuar dhe klienti bie dakort të paguaje tarifa të tjera shtesë për rezultatin pozitiv.

5) Avokati mund të ofrojë ndihmë ligjore falas për:

- a) personat që janë në vështirësi financiare;
- b) personat që mbështeten me ndihmë financiare;

6) Avokati mund të ofrojë shërbime pa pagesë për miqtë e ngushtë, të afërmit ose avokatë të tjerë.

Neni 29

TËRHEQJA E PËRFAQËSIMIT

1) Avokati nuk duhet të tërhiqet nga një perfaqësim i ndërmarrë, përveçse kur ka shkaqe të arsyeshme, siç janë midis të tjerash:

- a) Mbingarkesa ose njohuri të pamjaftueshme në një fushë të veçantë ligjore;
- b) Pandershmëria e arsyeve të klientit për të kërkuar asistencë ligjore;
- c) Kur klienti insiston që avokati të ndërmarrë veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin ose me kodin e etikës;
- d) Kur klienti insiston që avokati të ndërmarrë veprime që janë në kundërshtim me vlerësimin e tij profesional;

e) kur klienti nuk mund të paguajë për asistencën ose nuk përmbush detyrimet kontraktuale për pagesën e asistencës tashmë të ofruar;

2) Avokati nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij për t'u tërhequr nga një çështje në mënyrë ose në rrethana të tilla në të cilat klienti mund të mos jetë në gjendje të sigurojë në kohë asistencë ligjore.

KAPITULLI III

MARRËDHËNIET ME GJYKATËN

Neni 30

Avokati duhet të sillet me respekt, ndershmëri dhe integritet kundrejt gjykatës në funksion të përfaqësimit e mbrojtjes të interesave të klientit të tij brenda kufijve të caktuar nga ligji dhe kodi etik.

Neni 31

Avokati asnjëherë nuk duhet të kërkojë të ndikojë tek gjykata me mjete të ndaluara nga ligji, si dhe të kryejë sjellje që synojnë të prishin solemnitetin e gjykimit ose vetë gjykimin në themel të tij.

Neni 32

Avokati nuk mund t'i japë dhuratë, hua ose sende me vlere, një gjyqtari, apo një nëpunësi të gjykatës.

Keshilli Drejtues I Dhomes Kombetare e Avokateve mund të miratojë kërkesën e avokatit për të bërë një përjashtim nga ky rregull, në raste të veçanta.

Neni 33

Avokatit i ndalohet të paraqitet për të përfaqësuar interesat e klientit, para një gjyqtari me të cilin avokati është i lidhur ngushtë ose ka marrëdhënie intime.

Neni 34

Avokati nuk duhet të japë asnjëherë, me dijeninë e tij, informacion të rremë ose ç'orientues gjatë procesit gjyqësor.

Avokati asnjëherë nuk duhet të nxisë një dëshmitar që të bëjë një dëshmi të rremë.

Avokati asnjëherë nuk duhet të shkaktojë shtyrje të parsyeshme në seancat gjyqësore.

KAPITULLI IV

MARRËDHËNIET NDËRMJET AVOKATËVE

Neni 35

Marrëdhëniet ndërmjet avokatëve duhet të mbështeten në parimet e bashkëpunimit, ndërshtërisë dhe konfidencialitetit në interes të klientëve të tyre.

Neni 36

Avokati duhet t'i njohë avokatët e Dhomës Kombëtare dhe të reflektojë ndaj tyre mirësjellje e qendrime korrekte në përputhje me normat e etikës profesionale.

Neni 37

Avokati, për një çështje të veçantë mund të komunikojë me avokatin e palës tjetër. Nuk i lejohet avokatit që për çështjen konkrete të komunikojë me palën kundërshtare, kur di se përfaqësohet nga një avokat, pa pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 38

EMRI I AVOKATIT

Avokati që heq dorë përkohësisht nga ushtrimi i profesionit të tij për aq kohë sa është në marrëdhënie pune me administratën publike, nuk duhet të lejojë që emri i tij/saj të qendrojë në emrin e zyrës së avokatisë ose të përdoret në njoftimet profesionale të zyrës gjatë periudhës në të cilën avokati nuk merr pjesë aktivisht dhe rregullisht në zbatim të ligjit si anëtar i zyrës.

Neni 39

SJELLJA E DREJTË NË PROCEDURAT GJYQËSORE

Në procedurat gjyqësore me pale kundërshtare, me qëllim që të gjitha palët dhe avokatët të kenë akses në gjykatë në mënyrë të barabartë, avokati nuk duhet që pa njoftimin e palës tjetër ose avokatit të saj, të kontaktojë ose të japë dokumenta ose materiale gjykatës lidhur me një çështje në shqyrtim ose që do të silllet për gjykim, në rrethana që mund të kenë efektin ose që mund të japin përshtypjen e një dhënie përparësie të padrejtë për njerën palë.

Kjo dispozite nuk do të aplikohet për çështje kur veprime të tilla janë të lejuara nga ligji.

Neni 40

NDARJA E PAGESAVE

Avokati i cili ka marrë përsipër të përfundojë çeshtjet ligjore të papërfunduara të një avokati që ka vdekur, duhet t'i paguajë trashëgimtarëve të avokatit të vdekur, atë pjesë të pagesës totale, që në mënyrë të drejtë përfaqëson shërbimet e kryera nga avokati i vdekur.

Avokati mund t'ju paguaje asistentëve të tij të cilët nuk janë avokat pagën, sigurimin shoqëror dhe pagesa të tjera të ngjashme edhe nëse fondet burojnë nga tarifat e avokatit.

Neni 41

DEKLARIME TË NDALUARA

Avokati nuk duhet të krahasojë shërbimet e ij me shërbimet e avokatëve të tjerë.

Avokati nuk duhet të komentojë avokatët e tjerë për tarifat e veçanta ose për mënyren e ushtrimit të profesionit.

Avokati që kryen përfqësimin e një klienti i cili ka qënë përfaqësuar më parë nga një avokat tjetër nuk duhet të kritikojë shërbimet e kryera nga avokati i mëparshëm.

Neni 42

KONKURRIMI I PADREJTË

Avokati nuk duhet të bëjë asnjë përpjekje, të cilat nuk janë në përputhje me dinjitetin e profesionit për të marrë klientin e kolegut te tij.

Neni 43

PËRFAQËSIMI

Përpara ndërrmarjes të përfaqësimit të një klienti i cili ka qënë i përfaqësuar nga një avokat tjetër, avokati është i detyruar të bindet se marrëdhënia e mëparshme avokat-klient ka përfunduar ashtu siç duhet.

Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur klienti është përfaqësuar nga më shumë se një avokat në të njejtën kohë dhe ndërpret marrëdhëniet e përfaqësimit me njerin.

Neni 44

ASISTENT AVOKAT

Avokati është i detyruar të ndjekë punën e asistentit të tij, të ndajë përvojën me të dhe të mundësojë kualifikimin profesional të tij.

Avokati duhet të bëjë përpjekje që asistentet të veprojnë në përputhje me ligjin dhe Kodin e Etikës.

Avokati është i detyruar që me kërkesën e asistentit, të pajisë atë me një çertifikatë që vërteton kohëzgjatjen si asistent pranë tij.

Neni 45

MARRËDHËNIA ME AVOKATËT E PALËS TJETËR

Avokati nuk duhet të perfaqësojë ose këshillojë një klient në çështjet kur avokati i palës tjetër është bashkëshorti/ja prindi, fëmija ose motra a vëllai i avokatit, jeton me avokatin, ose ka marrëdhënie intime personale me avokatin, përveçse kur ky i fundit ka informuar klientin e tij me shkrim mbi këtë marrëdhënie.

Ky ndalim është i vlefshëm për ortakët e një zyre avokatie dhe ortakët e një shoqërie.

Neni 46

Në çështjet kur interesat e klientit mbrohen nga dy ose më shumë avokat që janë të pavarur nga njëri tjetri dhe kur avokatët mbrojnë opinione të ndryshme në lidhje me mundësitë për mbrojtjen e klientit, vendimi përfundimtar do të merret nga klienti. Avokatët që nuk pajtohen me vendimin, mund të heqin dorë nga përfaqësimi apo mbrojtja e klientit.

Neni 47

MARRËDHËNIET ME AVOKATËT E SHTETEVE TË TJERA

Avokati ka për detyrë të mos pranojë bashkëpunimin me një avokat i një shteti tjetër për një çështje për të cilën ai nuk është kompetent. Në këtë rast ai duhet të ndihmojë kolegun e tij për të kontaktuar me një avokat tjetër i cili mund të ofrojë shërbimin e kërkuar.

Neni 48

Kur avokati bashkëpunon me një avokat të një shteti tjetër, është i detyruar të marrë parasysh ndryshimet që mund të ekzistojnë midis sistemeve ligjore dhe kodeve etike përkatëse.

KAPITULLI V

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Neni 49

Aksesi ne Shërbime

Çdo person në shoqëri duhet të ketë akses të lehtë në shërbimet profesionale të pavarura të avokatit.

Neni 50

PUBLICITETI

Avokati ka te drejtë të reklamojë aktivitetin e tij, sipas rregullave dhe kufizimeve të përcaktuara në këtë Kod.

Reklamimi i avokatit ka për qëllim vetëm t'i ofrjë klientit informacionin e nevojshëm në mënyrë që ai të ketë mundësi të zgjedhë avokatin më të përshtatshëm.

Publiciteti nuk duhet:

1. që me mjete ose përmbajtje të kundërshtojë parime ose detyrime kryesore të avokatit të përcaktuar në këtë Kod;
2. të përmbajë informacion të rremë, të pasaktë ose corientues apo faktik i cili nuk mund të verifikoheet;
3. të bëjë krahasime ose të kritikojë avokatë të tjerë, vecanërisht tarifat ose menyen e kryerjes së profesionit prej tyre;
4. të përfshijë deklarime në lidhje me cilësinë e punës së avokatit, masën e aktivitetit të tij, tarifat speciale;
5. të identifikojë klientin përpara marrjes së miratimit të tij me shkrim.
6. çdo informacion tjetër që mund të shkelë dispozitat e këtij Kodi

Publiciteti mund të përmbajë informacion:

1. mbi fushat e ligjit në të cilat ushtron aktivitetin avokati;
2. rreth të kaluarës profesionale dhe formimit professional të avokatit;
3. rreth njohurive të gjuhëve të huaja;
4. lidhur me kohën e fillimit të aktivitetit, vendodhjen e selise se tij, ose ndryshimin e saj por jo me shume se 30 dite nga dita qe ka filluar/zhvendosur.

Neni 51

KËRKIMI I KLIENTËVE

Kërkimi i klientëve nëpërmjet një kontaktimi të drejtpërdrejtë me një klient të mundshëm me qëllimin e vetëm për ta bindur atë se ka nevojë për shërbimet e një avokati dhe me të cilin/cilën avokati nuk ka lidhje familjare ose lidhje të mëparshme profesionale ose nëpërmjet shfrytëzimit të një "sekseri", është i ndaluar.

Me përjashtim të çmimit të zakonshëm të publicitetit respektiv avokati nuk duhet t'i japë asgjë me vlerë një personi që rekomandon shërbimet e avokatit

Neni 52

DISA VEPRIMTARI TË NDALUARA PËR AVOKATET

Avokati nuk duhet të arrijë asnjë marrëveshje personalisht ose nëpërmjet një sekseri me klientin e tij për të siguruar pasuri ose të drejta të tjera, të cilat janë subjekt i ceshtjes.

Neni 53

TARIFAT REFERUESE

Avokati nuk duhet të kërkojë ose pranojë nga një avokat ose cdo person tjetër një tarifë, komision ose çdo lloj pagese tjetër për referimin ose rekomandimin e një klienti. Një avokat nuk duhet t'i paguajë askujt asnjë tarifë, komision ose çdo lloj pagese tjetër për faktin se i kanë referuar atij një klient.

Neni 54

SANKSIONE

Avokatet që nuk zbatojnë Kodin Etik bëjnë një shkelje disiplinore e cila bëhet shkak për nisjen e procedimit disiplinor dhe për marrjen e masave që parashikon Ligji Nr. 9109 datë 17.7.2003 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

DISPOZITË E FUNDIT

Kodi Etik i Avokatit mbasi iu nënshtrua diskutimit në Këshillin e Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë në datën 12.11.2005, u miratua me vendimin nr. 31 të këtij Keshilli. Data e hyrjes në fuqi të Kodit është 12.11.2005, dhe çfuqizon kodin e mëparshëm etik.